Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 23/17
Datë/Datum 13-02-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

DATË/A:	**13.02.2017**
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Menaxherin e prokurimit: **Korporata Energjetike e Kosoves sh.a.**
CC:	Paneli Shqyrtues – **OSHP Nr.23/17** OE ankues **"Euro Ing" Sh.P.K**
NËPËRMJET/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Muhamet Kurtishaj - Ekspert Shqyrtues/teknik
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**"Furnizim me pluhur ABC dhe shkumë -AR-AFFF"** me nr.prokurimi KEKO 16 329 121
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "Euro Ing" Sh.P.K"**

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP-së ju njoftojmë me raportin e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pluhur ABC dhe shkumë -AR-AFFF"** me nr.prokurimi KEKO 16 329 121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosoves sh.a.** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik **"Euro Ing" Sh.P.K"** me nr.**23/17** të datës **23.01.2017**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit, përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES/TEKNIK

		02.02.2017		03.02.2017		13.02.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të raportit		data e dorëzimit të raportit

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë **23.01.2017** Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesenme numër të protokollit **Nr.23/17** e parashtruar nga operatori ekonomik ekonomik **"Euro Ing" Sh.P.K"** me seli ne **Prishtinë** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pluhur ABC dhe shkumë -AR-AFFF"** me nr.prokurimi KEKO 16 329 121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosoves sh.a.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues* "Euro Ing" Sh.P.K" me seli ne **Prishtinë**

Pikat e Ankesës:

Është shkel nenin 1 i LPP-së i LPP-së (Qëllimi)
Është shkel nenin 6 i LPP-së i LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)
Është shkel nenin 7 i LPP-së i LPP-së (Barazia në trajtim/Jo diskriminimi)
Është shkel nenin 28 i LPP-së i LPP-së (Specifikimet teknike)
Është shkel neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).
Është shkel neni 69 i LPP-së (Aftësitë teknike dhe/ose profesionale)
Është shkel 72 i LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë).

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

- Konsiderojmë se AK ka shkelur nenin 28 paragrafi 2, 3, 4, 6, 7 dhe 9 pasi që gjatë vlerësimit nuk i është përmbushur kritereve të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në specifikimin teknik. Në dosjen e tenderit kanë kërkuar artikuj me karakteristika të caktuara, këta artikuj duhet ti plotësojnë standardin EN 1568-3
- Në ofertën tonë kemi kemi prezentuar katalogun dhe atestin nr. 04-11/13 i dt. 26.11.2013 i lëshuar nga instituti i xehtarisë nga Shkupi. Në këtë atest dokumentohet se i plotësojnë të gjitha karakteristikat e kërkuara teknike. Nga ky atest shihet se prodhimet e prodhuesit T.D MATO – DOOEL nga Shkupi janë në përputhje me standardin EN 1568-3.
- Në pozicionet ku kërkohen vetit: "Pikë e ngrirjes" dhe "Sedimentacioni pas vjetërsisë"artikujt me të cilët ne konkurojmë janë me veti edhe më të mira se ato që janë kërkuar.
- Pas pranimit të vendimit të AK në kërkesën për rishqyrtim, prodhuesi na ka dërguar argumentet e tjera si dëshmi se artikujt me të cilët konkurojmë i plotësojnë të gjitha karakteristikat e kërkuara, (ky dokument nuk është kërkuar në dosjen e tenderit as nuk ka qenë e domosdoshme të jetë pjesë e ofertës).
- Na habitë fakti se në njoftimin për tenderuesin e eleminuar dt. 05.01.2017 kanë cekur se citoj" "nuk keni ofruar AR (Alkohool Rezistent) e kërkuar në Anekx 1 të DT" kjo nuk është e qëndrueshme dhe dokumentohet në paragrafët paraprak.
- Gjithashtu jemi bafasuar se AK me dt. 11.10.2016 na kanë dërguar Letrën Standarde për tenderuesin e elminuar, dy vendime kontradiktore!!!!!!
- Stafi teknik i AK nuk ka vepruar conform neit 59.2 të LPP-së.

Dëmet Materiale

Dëmet material që na janë shkaktuar në këtë rast nuk janë shumë të rëndësishme dhe nuk kanë ndonjë vlerë në aspektin material porn a dëmton raportet kontraktuale me prodhuesin të cilat në afatgjatë mund të janë dëme material shumë të mëdha.

Propozim
Nuk eshte dhene ndonje propozim.

Procesi i prokurimit

Data e njoftimit për kontratë(N.40) :	08.09.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16):	furnizim/e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	29.09.2016 ora 13ºº
Data e hapjes së ofertave (N.58) -	29.09.2016 ora 13³º
Data e njoftimit për dhenie te kontrates	05.01.2017

III.2 KUSHTET PËR PJESMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP),

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të LPP-se, Neni 65, siç është e cekur ne piken a deri ne i do të dorëzohen në formë të Aneksit
2. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesitper piken j deri ne q .
3. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, se Operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë ne pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Për piken 2 dhe 3 kërkohet vetëm nga Operatori ekonomik qe propozohet për dhënien e kontratës

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i numrit fiskal;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e çertifikatës së biznesit);
2. Kopja e TVSH-se;
3. Kopja e numrit fiscal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional Kerkesat:

1. *Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë*
2. *Katalogje te produkteve*
3. *Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. *Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar (të bashkangjitur kopja e marrëveshjes e distributorit me prodhuesin), për shitjen e produkteve qe ofroni*
2. Katalogje nga prodhuesi me përshkrim te detajizuar per produktet e ofertuara
3. *Kopja e Certifikates se ISO Standardit 9001:2008 e prodhuesit*

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Emri i Tenderuesit	Vendi	Çmimi € Lot2	Vërejtje
1	" Eng Group"	Prishtinë	13.168,80	jo
2	"NP. "Euro ing"	Prishtinë	16.284,00	jo
3	"Pastor Kosova"	Prishtinë	19.207,68	jo

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Nuk ka pasur vërejtje për procesin e hapjes se ofertave nga asnjë operator ekonomik. Raporti i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes dhe përfaqësuesit e operatorëve ekonomik te pranishëm.

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60):..... Tenderi i përgjegjshëm **Çmimi më i Ulët**

Komisioni vlerësimit pranë AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka formuar komisionin me vendimin te datës 03.11.2016 në përbërje prej tre anëtarëve:

1. Ruzhdi Thaqi – Kryetar i Komisionit
2. Muhamed Rushiti - Anëtar
3. Luljeta Gusia – Anëtar

Data e mbarimit të vlerësimit të ofertave:.....05.12.2016
Data e e nënshkrimit nga zyrtari i prokurimit.....06.12.2016

Raporti i komisionit vlerësues

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për:

"Pastor Kosova" me ofertën në vlerë prej **19.222,20 €.**

Komisioni vlerësues ka konstatuar dhe vlerësuar si në vijim:
Operatoret që kanë ofertuar janë 3 (tre)
Operatoret ekonomik të përgjegjshëm janë 1
Operatoret ekonomik të pa përgjegjshëm janë 2

Deklarata e komisionit vlersues
Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave konkuruese ka ardhe ne perfundim se oferta e ofertuesit "**Pastor Kosova**" nga Prishtine të shpërblehet me kontratë.

Rishqyrtimi i kërkesës nga Autoriteti Kontraktues

E datën 10.01.2017, autoriteti kontraktues ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga OE **"Euro Ing" Sh.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pluhur ABC dhe shkumë -AR-AFFF"** me nr.prokurimi KEKO 16 329 121. Llidhur me kete kërkesë Autoriteti kontraktues me datën **13.01.2017** mori këtë:

Vendim

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e OE **"Euro Ing"** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pluhur ABC dhe shkumë -AR-AFFF"** me nr.prokurimi KEKO 16 329 121.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues/teknik (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës së Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që ka pasur në dispozicion eksperti shqyrtues-teknik jep mendimin si në vijim:

Konstatimi: Nr. 1

Ky aktivitet i prokurimit është publikuar nga autoriteti kontraktues me procedurë të hapur. Lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlere te mesme. Në dosjen e tenderit janë dhënë informata përkatëse lidhur me kontratën në fjalë.

Dosja përfshinë të gjitha termet dhe kushtet materiale të sajë, procedurat e zbatueshme të prokurimit, kërkesa të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes. Kriteri i dhënies së kontratës është në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Konstatimi nr. 2

Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, Eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 113 pika 1 të LPP-së, jep mendimin për pretendimet ankimore të OE ankues si në vijim.

Pretendimi ankimor i OE ankues se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 28 të LPP-së sepse gjatë vlerësimit nuk i është përmbajtur kritereve të kërkuara në dosjen e tenderit të dhënë në specifikimin teknik për mednimin e eksperit teknik është pretendim i **pa bazuar**.

Ky pretendim ankimor nuk është shtruar si duhet nga OE ankues. Nëse gjatë vlerësimit të ofertave nuk janë respektuar kriteret teknike të dhënë në dosjen e tenderit, atëherë nuk kemi të bëjmë me shkelje të nenit 28 të LPP-së sepse ky nen nuk është për vlerësim të ofertave por për është për punimin e specifikimeve teknike në dosjen e tenderit.

Konstatimi nr. 3

Pretendimi tjetër ankimor i operatorit ekonomik ankues se autoriteti kontraktues ka shkelë nenin 59 të LPP-së(ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) për mendimin e ekspertit teknik është i **pa bazuar**.

Autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave në bazë të kriterëve të dhënies së kontratës. Arsyeja e eleminimit të OE ankues është sepse njërin prej produkteve që ka ofruar nuk është me atë që është kërkuar në dosjen e tenderit. Fjala është për produktin e kërkuar:

-**AR/AFFF-3%/6%** ndërsa OE ankues ka ofruar produktin
-AFFF-**3%/6%** pra mungon **AR(Alkohol Rezistent)** në produkt.

Pra ekspertit teknik mendon se autoriteti kontraktues ka vepruar drejtë me rastin e eleminimit të OE ankues sepse produkti i ofruar nga OE në fjalë nuk është ai që është kërkuar në dosjen e tenderit.

Konstatimi nr. 4

Pretendimi vijues i OE ankues se autoriteti kontrkatues ka lëshuar dy vendime kontradiktore për shkak se me datën 11.10.2016 na ka dërguar Letrën Standarde për tenderuesin e sukseshëm ndërsa me datën 05.11.2016 na ka dërguar Letrën Standarde për tenderuesin e eleminuar qëndron, mirëpo kjo ka ndodhë në procedurë të rregullt sepse fillimisht komisioni vlerësues e ka rekomanduar për kontratë OE ankues "Euro Ing".

Pas njoftimit për dhënie të kontratës nga AK, pastaj ka bërë kërkesë për Rishqyrtim OE tani i rekomanduar për kontratë "Pastor Kosova" me pretendim ankimor pikërisht për shkak të këtij parametri **AR(Alkohol Rezistent)** që nuk e ka ofruar sipas dosjes se tenderit OE **"Euro Ing".** Kjo kërkesë per Rishqyrtim ju ka aprovuar nga autoriteti kontraktues operatorit ekonomik "Pastor Kosova" dhe aktiviteti i prokurimit ka shkuar në rivlerësim.

Pas rivlerësimit të oferta, OE ankues "Euro Ing" është shpallë i pa përgjegjshëm. Në bazë të kësaj që u tha Eksperti teknik e vlerëson si pretendim **pjesërisht të bazuar**.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

Me rastin e rivlerësimit të ofertave nga autoriteti kontraktues, nuk ka pasur shkeljet të neneve të përmendura në ankesë nga OE ankues, sepse OE "Euro Ing" eshte shpalle i pa përgjegjshëm per shkak se nuk e ka ofruar njërin nga produktet e kërkuar sipas dosjes se tenderit. Prandaj asnjëra nga nenet e LPP-se te theksuara ne ankese nuk lejojojne qe te shpërblehet me kontrate OE i pa përgjegjshëm.

Përgjigje në pikat e ankesës

Përgjigjeje për pikat e ankesës janë dhënë në konstatimet e lartshënuara.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Eksperti shqyrtues-teknik e vlerëson të **pjesërisht të bazuar** ankesën e OE ankues **"Euro Ing"** mirëpo kjo nuk do ta ndryshoj rrjedhjen e aktivitetit të prokurimit.
Bazuar në gjitha konstatimet dhe sqarimet e dhëna gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon që autoriteti kontraktues – **Korporate Energjetike e Kosovës sh.a,** të **vazhdoj** me dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pluhur ABC dhe shkumë -AR-AFFF"** me nr.prokurimi KEKO 16 329 121 në përputhje me dispozitat e LPP-së.